



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1574/8 Prot.,

Datë 22.07.2024

**V E N D I M**

**Nr. 908 /2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.07.2024 me

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-03081-04-30-2024, me objekt “Blerje Qelqurina”, me fond limit 4,028,936. lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-03081-04-30-2024, me objekt “Blerje Qelqurina”, me fond limit 4,028,936. lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “ALMedical” SHPK dhe “LAB CHEM DISTRIBUTION” SHPK në procedurën e prokurimit sipërcituar.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK me Nipt. L92207009A. Adresa: Rr. Dibrës, kompleksi Arlis, Farmacia 10, Tiranë.

Operatori ekonomik "ALMedical" SHPK, me Nipt, K21511002I, Adresa: Rr. Shefqet Musaraj, Banesa nr. 17 Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë  
Adresa: Rr. Qamil Guranjaku, Tiranë.

**Subjekte të Interesuara** Operatori ekonomik "ALMedical" SHPK, me Nipt, K21511002I, Adresa: Rr. Shefqet Musaraj, Banesa nr. 17 Tiranë

Operatori ekonomik "LAB CHEM DISTRIBUTION" SHPK, me Nipt, M12429007A, adresa Rr. Teleferikut, Zona Kadastrale Nr. 2460, Nr. pasurie 192/41-118, Linzë, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimesit, të autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit janë operatorë ekonomikë ankimues, për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.5. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.05.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-03081-04-30-2024, me objekt “Blerje Qelqurina”, me fond limit 4,028,936. lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton, se autoriteti kontraktor në datën 07.06.2024, ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në sistemin e prokurimeve elektronike (S.P.E.), dhe kryer renditjen e rezultateve të vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

1. “ALMedical” SHPK	Vlera	3,021,720 Lek pa TVSH	skualifikuar
2. “ISOMETRIC” SHPK	“	3,041,550	“ skualifikuar
3.LAB CHEM DISTRIBUTION SHPK “	“	3,575,550	“ kualifikuar

II.3. Autoriteti Kontraktor më datë 10.06.2024 ka publikuar Njoftim Fituesi Paraprak.

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi A/2024/4210 datë 13.06.2024 dhe me Nr. 1574/2024 Prot., date 13.06.2024 e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-03081-04-30-2024, me objekt “Blerje Qelqurina”, me fond limit 4,028,936. lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “ISOMETRIC” SHPK nga procedura e prokurimit sipërcituar, si edhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “ALMedical” SHPK dhe “LAB CHEM DISTRIBUTION” SHPK.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij,

të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 1574/2 prot., datë 14.06.2024 lidhur me pretendimet mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.6. Në përfundim të afatit 5 ditor, brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar në sistem, shkresa nr. 1587/1 prot., datë 18.06.2024, protokolluar me tonën me Nr.1574/3, datë 18.06.2024, dhe në formë shresore protokolluar me tonën me Nr. 1574/4, datë 19.06.2024 me objekt *“Kthim përgjigje Ankesës me nr. 1587 prot., datë 13.06.2024” për dijeni KPP-së dhe të gjithë OE të interesuar*”.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me vendimin datë 18.06.2024, ka vendosur mospranim të ankesës.

II.7. Me shkresën 1574/5 prot., datë 24.06.2024 me objekt *“Njoftim për seancë dëgjimore”* Komisioni i Prokurimit Publik ka këkuar në mënyrë të përmbledhur:

*[...] Nga shqyrtimi paraprak i ankesës Nr. 1574/2024 Prot., date 13.06.2024 e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK vihet re se ngre pretendime mbi vlerësimet e specifikimeve teknike të mostrave të paraqitura në ditën e hapjen së ofertave në procedurën e prokurimit sipërcituar.... me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nenit 23 të Vendimit Nr.766 datë 13.10.2021, të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, KPP gjykon të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e institucionit tonë me përfaqësues të operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK si edhe përfaqësues të autoritetit kontraktor të cilët kanë hartuar specifikimet teknike për këtë procedurë prokurimi, si dhe përfaqësues të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, pranë autoritetit kontraktor.*

*Seanca dëgjimore do të zhvillohet ditën e Enjte datë 27.06.2024, ora 12:00, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik. [...]*

II.8. Më datë 27.06.2024 ora 12:00, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt Seanca dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik ankimues “ISOMETRIC” SHPK dhe autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Seanca dëgjimore u regjistrua audio në sistemin e ankesave elektronike nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik

II.9. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, pranë Komisionit të Prokurimit Publik apo edhe në sistem, nuk janë paraqitur argumente nga operatorët ekonomikë të interesuar, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.10. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimi A/2024/4222 datë 14.06.2024 dhe me Nr. 1597/2024 Prot., date 18.06.2024 e operatorit ekonomik

“ALMedical” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-03081-04-30-2024, me objekt “Blerje Qelqurina”, me fond limit 4,028,936. lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues nga procedura e prokurimit sipërcituar.

II.11. Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit nr. 1597/2 prot., datë 19.06.2024 lidhur me pretendimet mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.12. Me shkresën 1597/5 prot., datë 12.07.2024 me objekt “Njoftim për seancë dëgjimore” Komisioni i Prokurimit Publik ka këkuar në mënyrë të përmbledhur:

*[...] Nga shqyrtimi paraprak i ankesës operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK vihet re se operatorit ekonomik ngre pretendime mbi vlerësimet e specifikimeve teknike të mostrave të paraqitura në ditën e hapjen së ofertave në procedurën e prokurimit sipërcituar... me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe nenit 23 të Vendimit Nr.766 datë 13.10.2021, të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, KPP gjykon të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e institucionit tonë me përfaqësues të operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK si edhe përfaqësues të autoritetit kontraktor të cilët kanë hartuar specifikimet teknike për këtë procedurë prokurimi, si dhe përfaqësues të Komisioni të Vlerësimit të Ofertave, pranë autoritetit kontraktor.*

*Gjithashtu, refeuar arsyes së skualifikimit të ankimuesit, Autoriteti kontraktor të sjellë në seancën dëgjimore, mostrën për të cilën ankimuesi “ALMedical” SHPK është skualifikuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi.*

*Seanca dëgjimore do të zhvillohet ditën e Martë datë **16.07.2024**, ora **11:00**, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik.*

*Përsa më sipër, ju kërkohet të gjithë palëve të siguroni pjesëmarrjen tuaj në këtë seancë dëgjimore. [...]*

II.13. Më datë 16.07.2024 ora 11:00, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt Seanca dëgjimore me përfaqësues të operatorit ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK dhe autoritetit kontraktor Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.

Seanca dëgjimore u regjistrua audio në sistemin e ankesave elektronike nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Operatorit ekonomik ankimues iu dorëzuar CD e seancës shoqëruar me pr-v dorëzimi.

II.14. Autoriteti Kontraktor me shkresën Nr.1917 prot., datë 16.07.2024, protokolluar me tonën me nr.1597/6, datë 16.07.2024, ka përcjellë “Dokumentacion plotësues” kërkuar gjatë seancës dëgjimore në lidhje me administrimin, verifikimin dhe testimin e mostrave në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik,**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton:**

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK, i cili kundërshton arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

*“Referuar Dokumentave Standarte të Tenderit: Seksioni 2; Kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.3: Kapaciteti teknik, pika e, nga ofertuesit e mundshëm kërkohet*

*2.4 d) Për artikujt e shënuar me Asterisko (\*), duhet të paraqiten mostra ditën e hapjes se ofertave, me date 29.05.2024 ne orën 10:00. Dorëzimi i kampioneve/mostrave, të bëhet pranë Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse pranë NJVKSH Tiranë, te mbyllura ne nje zarf/kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:*

– *“Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit « ..... » dhe jo para dates 29.05.2024, ora 10:00.*

– *Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkresë te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.*

– *Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.*

*Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçantë, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s’kualifikohet.*

*Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas marrjes në dorëzim të mostrave procedoi duke mbajtur një proces verbal për numërtimin e mostrave për testim dhe i dërgoi me shkresë shefit të Sektorit të Shërbimit të Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor (këtu e më poshtë SESHM) me nr.1386 prot, datë 31.05.2024 për verifikim profesional ose testim sipas rastit të mostrave. Në bazë të kthimit të përgjigjes nga shefi i SESHM me nr.1386/1 prot, datë 06.06.2024 rezulton se pas gjykimit për verifikim profesional ose testim sipas rastit të mostrave nga përdoruesit direkt të tyre,*

*Artikulli me nr 17, pjata petri, Ø 60 njeperdorimshe, polistiren, e operatorit ekonomik ISOMETRIC, madhësia e pjatës është e vogël dhe sipërfaqja e saj nuk krijon kushtet e nevojshme për rritjen e mikrobit.*

*Gjithashtu në katalogun e dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga operatorit ekonomik ISOMETRIC, Artikulli me nr 17 është markuar për Ø55 dhe jo me Ø60, rrjedhimisht jo sipas specifikimeve teknike të kërkuara.”*

**Me argumente:** 1. Gjykojmë se AK është i pa mbështetur ligjërisht për të bërë një vlerësim profesional ose testues pasi laboratorit i institucionit përkatës nuk posedon asnjë certifikim/akreditim ose prove tjetër teknike për të matur diametrin ose milimetrat e pjatës së petrit pra artikullit nr 17.

Gjithashtu citojmë se po ky institucion nuk posedon kapacitet certifikues/testues jo vetëm për vlera metrike sepse nuk e ka në profilin e tij, por nuk mund të merret për bazë as testet të cilat ka provuar pjatat pasi janë teste të pa akredituara dhe të pa validuara.

Kërkojmë nga AK të na specifikojë mënyrën e matjes së diametrit të pjatës, është matur me vizore apo me kalibër?

Ka një dokument provues për mënyrën e matjes?

Si ka arritur AK të konstatojë që kjo pjatë nuk krijon kushtet e nevojshme për rritjen mikrobike?

Vlersojmë se AK, nuk disponon asnjë kapacitet teknik për të qënë trup vlerësuese për matje të materialeve laboratorike dhe vlerësimi në këtë orientim është i pa bazuar në certifikime ose në ndonjë dokument vërtetues dhe komentet përkatëse mbeten në kuadër opiniononi e pa prova ligjore.

2. Përtej citimit të AK mbi vlerësimin e pjatës së petrit, edhe përtej faktit që ak është i pamundur ligjërisht të bëjë vlerësim të parametrave milimetrike të artikullit nr 17, sërish në themel edhe argumentimi teknik është i pasaktë.

AK ka theksuar se: artikulli me nr 17 është markuar për Ø 55 dhe jo me Ø 60, rrjedhimisht jo sipas specifikimeve teknike të kërkuara rrjedhimisht, sic shihet edhe në foton e mësipërme, foto e marrë nga katalogu i ngarkuar në sistem (bashkengjiur katalogu i përkthyer dhe i noterizuar), shihet qartë se Ø 55 është fija e bazës në mm pra është diametri i brëndshëm pra diametri i bazës kurse Ø 60 është diametri i kapakut mbulues se pjatës. Të gjithë prodhuesit këtë dimension prodhojnë, është standart tip. Por disa prodhues shprehin diametrin e pllakës mbuluese pra Ø 60 kurse prodhues të tjerë pronocohen për diametrin e bazës funksionale Ø 55.

Kërkojmë që artikulli nr 17, pjatë petri Ø 60 të vlerësohet nga një ekspert nëse i përmbush kërkesat e paraqitura edhe pse gjykojmë që ak e ka shumë të qartë që ky refuzim për këtë pretendim është absurd.

**Kërkesë për ekspertizë të posacme**

**Vlerësojmë që është e nevojshme për ekspertizë teknike për vlerësimin e përputhshmërisë së parametrave teknikë të artikullit 17 pjatë petri të operatorit ekonomik ISOMETRIC SHPK**

III.1.1. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar në sistem, shkresa nr. 1587/1 prot., datë 18.06.2024, protokolluar me tonën me Nr.1574/3, datë 18.06.2024, dhe në formë shresore protokolluar me tonën me Nr. 1574/4, datë 19.06.2024 me objekt “Kthim përgjigje

Ankesës me nr. 1587 port., datë 13.06.2024”. për dijeni KPP-së dhe të gjithë OE të interesuar”.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me vendimin datë 18.06.2024, ka vendosur mospranim të ankesës.

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se:

*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në nenin 3, “Parime të përgjithshme”: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 21, “Autoriteti ose enti kontraktor” 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.1.3. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit 162/2021 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë



intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në

*fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.”.*

III.1.4. Neni 77 pika 1 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]*

III.1.5. Në nenin 40, pika 6, “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
- c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.6. Neni 3, “Zhvillimi i mbledhjeve të hapura/seanca dëgjimore” i Vendimit Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të Komisionit të Prokurimit Publik.

*1. Komisioni, kur gjykon të nevojshme, që për zgjidhjen e çështjes nevojitet prania e palëve për të dëgjuar mbi provat dhe pretendimet e tyre, ka të drejtë të vendosë zhvillimin e mbledhjeve të hapura/seancave dëgjimore, përmbajtja e të cilave duhet të pasqyrohet në procesverbal.*

2. Kur mbledhjet bëhen të hapura duhet të bëhet njoftimi për datën, orën dhe vendin e mbledhjes, në mënyrë që të garantohet njoftimi i palëve të interesuara. Ky njoftim bëhet te paktën 72 orë përpara datës së mbledhjes.

3. Njoftimi bëhet me shkrim në formë shkresore si dhe me mjete elektronike.

4. Në mbledhjet e në/seancat dëgjimore, Komisioni mund të thërrasë edhe palë të treta ose ekspertë të cilët japin ekspertizë për çështjet që trajtohen.

III.1.7. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST shtojcat 5 dhe 6,

### Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

#### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

##### Specifikimi i Materialeve

Nr	Emertimi	Specifikime	Njesia
1	Ambalazh njeperdorimsh	Me tiosulfat per marrje mostre te ujit, sterile, 250 ml, material Polipropilen	cope
2*	Ambalazh njeperdorimsh	Me tiosulfat per marrje mostre te ujit, sterile, 500 ml, material Polipropilen	cope
3	Ansa njeperdorimshe	Ansa blu njeperdorimshe 10 µl unaze sterile, Polistiren	cope
4	Balone	I taruar, qelqi, klasi A, zjarrdruues, 500 ml, tolerance ± 0.250 ml	cope
5	Beaker	I shkallezuar, qelqi Borosilikat zjarrdruues, 400 ml	cope
6	Beaker	I shkallezuar, qelqi, zjarrdruues, 500 ml	cope
7*	Beaker	I shkallezuar, qelqi Borosilikat, zjarrdruues, 1000 ml	cope
8*	Kosh (mbajtese tubash)	inoks, me permasa afersisht 20x20x20 cm	cope
9	Kriotuba	per ruajtjen e materialeve biologjike ne temperatura shume te uleta , 2 ml, sterile	cope
10*	Tampon	Tampona Steril me epruvete PP, me dimensione 12x150 mm (pa terren)	cope
11	Kupshore	Kupshore porcelani Ø 10-11 cm, fundsheshte	cope
12*	Lama	Lama me permasa 26x76 ,jo korrozive, trashesi 1 mm, kuti/50 cope	kuti
13*	Lamela	Lamela me permasa (22x22), kuti/200 cope	kuti
14*	Maja pipete	Maja per mikropipete Ependorf, ose ekuivalent, 10-100 µl	cope
15*	Pipeta	Klas AS me shkallezim me ngjyre blu, qelq Volum 10 ml	cope
16	Pjata petri	qelqi, Φ 90 mm, zjarr duruese, lartesia 2 cm	cope
17*	Pjata petri	Ø 60 njeperdorimshe, polistiren	cope
18*	Pjata petri	Ø 90 njeperdorimshe, polistiren	cope
19*	Pjata petri	Ø 120 njeperdorimshe, polistiren	cope
20	Puar	gome pipetimi universal me tre valvola	cope

21	Tampona	Tampon me pambuk, me bisht druri qese me 100 cope	qese
22	Termoboks	me pllake akulli, 22.5 litra	cope
23*	Tuba	Epruvete per perzierje ,qelq qe ti rezistojte temperaturave te autoklavimit,me gryke zmerile,me tape,e graduar , 50 ml me NS19/26	cope
24*	Tuba Durhan	Ø35x6 mm trashesia e pareteve 0.65 mm	cope
25*	Tuba qelqi	Ø 12x100 mm	cope
26*	Tuba qelqi	Ø 30x200 mm me fund te rrumbullaket	cope

- **Afati i skadencës për qelqurinat: Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit, për ato artikuj në të cilën aplikohet skadencia, duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës.**
- **Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimi për çdo artikull.**

## Shtojca 7 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.3 Kapaciteti teknik:

**b) Për të gjithë artikujt e kërkuar** sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (*Specifikimet teknike*), **te paraqitet Katalogje, ku te përfshihen specifikimet teknike te hollësishme për artikullin e kërkuar**(*pjeset e katalogut qe permbajne emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike te artikullit qe ofertohe, nese nuk jane ne gjuhen shqipe, te perkthehen ne gjuhen shqipe dhe te noterizohen*). Operatori ekonomik duhet të markoje ne katalogun perkates produktet qe ofron sipas numrit rendor (**te markuara sipas artikullit**) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.

**d) Për artikujt e shënuar me Asterisko (\*), duhet të paraqiten mostra** ditën e hapjes se ofertave, me date 13.05.2024 ne oren 10:00. Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet prane Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse pranë NJVKSH Tiranë, te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:

- “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit « ..... » dhe jo para dates 13.05.2024, ora 10:00.
- Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkrese te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr.Rendor te Artikullit qe përfaqëson.

**Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçantë, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s’kualifikohet**

III.1.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të ofertë operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK, ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronike rezulton, se në përmbushje të kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit sipër cituar, operatori ka ngarkuar:

**Katalog\_Anglisht**

**Katalog\_Shqip (perkthim dhe noterizim)**

III.1.9. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit, Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor.

Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore mes palëve në lidhje me arsyen e skualifikimit dhe përmbushjen e specifikimeve teknike nga ana e operatorit ekonomik ankimes.

III.1.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike dhe kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.

KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, konkretisht **pikës 2.3. pika b) dhe d)** rezulton, se është kërkuar shprehimisht që:

**b) Për të gjithë artikujt e kërkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike), te paraqitet Katalogje, ku te përfshihen specifikimet teknike**

te hollësishme për artikullin e kërkuar(pjeset e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) të percaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

**d) Për artikujt e shënuar me Asterisko (\*), duhet të paraqiten mostra ditën e hapjes së ofertave, me datë 13.05.2024 në orën 10:00. Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet pranë Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse pranë NJVKSH Tiranë, të mbyllura në një zarf /kufi jo transparente të vulosur....:**

Referuar ankesës, Operatori ekonomik ankimues ISOMETRIC SHPK i skualifikuar për mospërmbushje të specifikimeve teknike për artikullin **nr. 17 Pjate Petri Ø 60** ndër të tjera ngre pretendime se: [...] **sic shihet edhe në foton e marrë nga katalogu i ngarkuar në sistem (bashkëngjitur katalogu i përkthyer dhe i noterizuar), shihet qartë se Ø 55 është fija e bazës në mm pra është diametri i brëndshëm pra diametri i bazës kurse Ø 60 është diametri i kapakut mbulues së pjetës.**

**Të gjithë prodhuesit këtë dimension prodhojnë, është standart tip. Por disa prodhues shprehin diametrin e pllakës mbuluese pra Ø 60 kurse prodhues të tjerë pronocohen për diametrin e bazës funksionale Ø 55. [...]**

III.1.11. Gjatë Seancën dëgjimore të zhvilluar në mjediset e KPP-së më datë 27.06.2024, lidhur me arsyen e mësipërme të skualifikimit kundërshtuar nga ankimuesi, iu dha mundësi palëve të shprehin argumentet e tyre lidhur me sa më sipër.

Komisioni pyeti palët në lidhje me kërkesat paraprake dhe u vërejt se nuk kishte kërkesa paraprake, pranuar nga palët në seancën dëgjimore.

Lidhur me artikullin **Artikulli me nr 17, pjata petri, Ø 60 njeperdorimshe, polistiren**, gjatë seancës dëgjimore palët kanë shprehur në mënyrë të përmbledhur argumentet e tyre si vijon:

[...] **OE:** Referuar artikullit **17 pjata petri Ø 60 njeperdorimshe, polistiren** artikulli i ofruar nga ne është artikull standard dhe kompania jonë prononcohet se ka diametër të bazës 55 ml, është steril, kapaku që mbivendoset është 60 ml.

**AK nuk është prononcuar se 60 është përmasa e bazës së brendshme, se jashtme apo e kapakut? AK si ka arritur që hapësira e brendshme nuk është e përshtatshme për rritjen mikrobike, a është AK i certifikuar të vlerësojë mostrat, dhe si e vlerësoi? ....**

**A është i mundur dhe certifikuar, apo ka ISO të vlerësojë mostrat? Prandaj kërkojmë ekspert.**

**KPP:** Ku është mbështetur AK për vendosjen e specifikimeve teknike? **Ø 60** është bazamenti apo jo.

**AK:** Në lidhje me përmasat e **Pjetës Petri Ø 60 njeperdorimshe, polistiren**, është bazamenti i pjetës dhe është i mjaftueshëm për të punuar sipas kërkesave të mjekëve që punojnë me këto pjata dhe ne kemi reflektuar dhe kërkuar përmasat.

**KPP:** Ka standartde në lidhje me kërkesat?

**AK:** Ne kemi vite që punojmë me këto pjata dhe kemi prokuruar ndër vite duke i realizuar me sukses procedurat. **Pjetës Petri Ø 60 është bazamenti i pjetës.** Operatorët e tjerë kanë sjellë pjatat për mostra **Pjetës Petri Ø 60, dhe mjekët i kanë vlerësuar të gjitha mostrat pasi janë përdorues të tyre.**

**KPP:** pyetje për OE ankimues, a keni bërë ankesë apo kërkesa për sqarim tek AK në lidhje me art 17?

**OE:** Kemi bërë ankesë për mostrat në përgjithësi jo në vecanti për këtë artikull pasi AK nuk duhet të kërkojë mostra pasi nuk është në gjendje të vlerësojë artikujt. Nuk ka pse të kërkonte mostra se nuk ishte i mundur verifikimi i tyre nga AK..

**AK:** Pjatat janë me përmasa të ndryshme dhe ne kemi kërkuar sipas përmasave që punojmë. Dhe mjekët i dinë përmasat që duhen.

**KPP:** A ka kërkuar AK sqarime nga OE në lidhje me mostrat?

**AK:** Nuk kemi kërkuar pasi ne jemi bazuar tek katalogu që OE ka ngarkuar në SPE, dhe kemi ndjekur procedurën e marrjes në dorëzim dhe vlerësimet e mostrave të numërtuar dhe pa emra janë vlerësuar nga mjekët që punojnë si e kemi shprehur në vlerësimet e kryera nga ne.

**OP:** Pjatat 50, 60 nuk përdoren për analiza mikrobik por janë më të mëdha për standardet.

**AK:** Nuk jemi mbledhur për këto konstatime por për të sqaruar që pjata është Ø 55 apo Ø 60

**KPP:** Kërkojmë nga OE të tregojë në katalogun në kompjuter artikullin e markuar nga ju.

**OE:** Në katalog faqe 16 është artikulli Ø 55 që prodhuesi citon që është baza Ø 55 dhe kapaku Ø 60.

**AK:** Sipas katalogut tuaj ku është përvaktuar që është përmasa e bazës? Specifikimet nuk plotësohen nga mostra juaj Ø 55 e cila nuk është kërkuar për art 17.

**OE:** Pse AK nuk ka përcaktuar që Ø 60 është baza apo kapaku, përmasa të brendshme apo të jashtme..

**AK:** Nuk konceptohet që ne të këkojmë përmasa kapaku, Ø 60 është baza.

**KPP:** A ka standarde ku të jenë përcaktuar përmasat?

**AK:** Labororet tona dhe mjekët që punojnë kanë shumë vite që përdorin pjatat me përmasat sipas përmasave që ata përdorin në punën e tyre. [...]

Operatorit ekonomik ankimues "ISOMETRIC" SHPK, gjatë seancës dëgjimore, iu dha mundësia të evidentonte përmbushjen e specifikimeve teknike nëpërmjet shfaqjes së dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (katalogët) nga ankimuesi, nëpërmjet shfaqjes së këtij dokumentacioni në një ekran LED

Në katalogun shoqëruar të tij, shfaqur në ekran, operatori pranoi që artikulli i ofruar prej tij ka përmasa të bazës **Pjatë Petri Ø 55**.

Gjatë Seancës dëgjimore KPP pyeti ankimuesin nëse kishte bërë ankesa për specifikimet teknike e konkretisht për artikullin 17. Operatori ekonomik u shpreh se nuk ka kundërshtuar specifikisht përmasat e art.17, por në përgjithësi artikujt e kërkuar nga AK.

Në seancën dëgjimore përfaqësuesit e autoritetit kontraktor kanë sqaruar se për **art 17 Pjatës Petri Ø 60 njeperdorimshe, polistiren** përmasa Ø 60 është përmasa e bazës së pjatës dhe jo e kapakut siç operatori pretendon.

Gjatë seancës dëgjimore, Komisioni i Prokurimit Publik, i drejtohet përfaqësuesve të autoritetit kontraktor, nëse gjatë vlerësimit të procedurës nëse i është drejtuar me kërkesë për sqarim operatorit ekonomik ankimues, lidhur me përmbushjen e këtyre kërkesave për kualifikim. Përfaqësuesit e autoritetit kontraktor, pranojnë se nuk kanë kërkuar sqarime nga ankimuesi, lidhur me mostrën objekt skualifikimi.

III.1.12 Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë

në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit.

Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “*Për prokurimin publik*” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”,

Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë perkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të



punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t'i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Çëshjta C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mberëtëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

III.1.13. Në këtë kuptim KPP gjykon referuar dokumentacionit të dosjes administrative si edhe seancës dëgjimore të datë 27.06.2024, ku palët argumentuan qëndrimet e tyre në lidhje me specifikimet teknike dhe vlerësimin e mostrave.

Komisioni përsa referuar më sipër konstaton se autoriteti kontraktor me specifikimet teknike objekt-ankimi, ka vështirësuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke ulur konkurrencën dhe duke sjellë vështirësi tek ofertuesit të interesuar për këtë procedurë prokurimi. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor gjatë hartimit të specifikimeve teknike të dokumenteve të prokurimit objekt-ankimi, duhet të kishte pasur parasysh parashikimet ligjore e konkretisht, neneve 2, 3 dhe 36 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar. Në këto kushte, KPP gjykon, se specifikimet teknike sa më sipër hartuar nga autoriteti kontraktor, kanë shkaktuar konfuzion të operatorëve ekonomikë si edhe pabarazi në vlerësimin e ofertuesve dhe njëherazi kanë vështirësuar punën e KVO-së, duke u bërë shkak për ankesa në vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

Dokumentet e tenderit duhet të jenë të qarta dhe të sakta në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Mospërcaktimi i saktë i specifikimeve teknike shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuat, *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;* nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj*”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimitarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) *Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]*”, gjykon, se për shkak të konfuzionit të krijuar procedura e prokurimit duhet të anulohet nga autoriteti kontraktor dhe në rishpalljen e saj autoriteti duhet të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi duke saktësuar specifikimet teknike.

Sa më sipër, pretendimet e ankimuesi qëndrojnë pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “ISOMETRIC”SHPK për operatorët ALMedical shpk dhe LAB CHEM DISTRIBUTION shpk, Komisioni nuk do t’i marrë në shqyrtim përsa kohë procedura e prokurimit do të anulohet.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK i cili kundërshton arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

*Referuar Dokumentave Standarte të Tenderit: Seksioni 2; Kriteret e vecanta të kualifikimit, pika 2.3: Kapaciteti teknik, pika e, nga ofertuesit e mundshëm kërkohet 2.3 d) Për artikujt e shënuar me Asterisko (\*), duhet të paraqiten mostra ditën e hapjes së ofertave, me date 29.05.2024 ne oren 10:00. Dorëzimi i kampioneve/ mostrave, të bëhet pranë Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse pranë NJVKSH Tiranë, te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:*

- “*Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « ..... » dhe jo para dates 29.05.2024, ora 10:00.*
- *Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkrese të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen ne zarf/kuti.*

– Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr.Rendor të Artikullit që përfaqëson.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuar sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s'kualifikohet.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas marrjes në dorëzim të mostrave procedoi duke mbajtur një proces verbal për numërtimin e mostrave për testim dhe i dërgoi me shkresë shefit të Sektorit të Shërbimit të Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor (këtu e më poshtë SESHM) me nr.1386 prot, datë 31.05.2024 për verifikim profesional ose testim sipas rastit të mostrave. Në bazë të kthimit të përgjigjes nga shefi i SESHM me nr.1386/1 prot, datë 06.06.2024 rezultoi se pas gjykimit për verifikim profesional ose testim sipas rastit të mostrave nga përdoruesit direkt të tyre, Artikulli me nr 14, maja pipete, Maja për mikropipete Ependorf,ose ekuivalent, 10-100 µl , e operatorit ekonomik Almedical, nuk janë të përshtatshme për mikropipetën (10-100 µl) që procedojmë. Maja nuk qëndron e fiksuar dhe bie, gjë që bën të pamundur procedimin me të. Në katalogun e dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga operatorit ekonomik Almedical, Artikulli me nr 14 është markuar për 5-100 µl.

ankimuesi argumenton:

[...] Citimi i skualifikimit për OE Almedical që majat e ofruara nga kompania jone nuk janë të përshtatshme për mikropipetën që ata procedojnë duke mos theksuar që mikropipeta që ky institucion procedon është Ependorf apo brand tjetër, ngrejme pretendimin që nuk kemi të bëjmë me një vlerësim të drejtë. Kjo na bën të ngrejmë dyshimin që Autoriteti Kontraktor nuk ka bërë vlerësimin sipas specifikimeve teknike të kerkuara për aparatën Ependorf për aq kohë sa nuk i referohet emrit të mikropipetes ku ky institucion ka provuar mostren. Përpos kësaj nëse Autoriteti kontraktor nuk ka specifikuar modelin e sakte të mikropipetes duke lënë në fuqi emrin pipete(ependorf) që nuk ka lidhje me produktin që ata përdorin, kjo do të thotë që nuk ka saktësuar specifikimet teknike dhe ka çuar kompaninë tonë drejt zgjedhjes së produktit të përshtatshëm me mikropipetën Ependorf dhe jo me të mikropipetes që ky institucion realisht përdor.

Vijojmë me tej për të provuar që mostra e prezantuar nga ana jone përmbush 100% specifikimet teknike të kerkuara.....

Maja e pipetes që OE Almedical ka prezantuar nuk ka diametër me të gjere të pjesës së montimit që të bëjë nga mikropipeta ashtu sik AK pretendon, por ka diapazon të gjere që nënkupton që mund të thihet solucion edhe me pak se 10 µl, pra mund të marrë nga 5-100 µl solucion. Mikropipeta ka funksionalitet gradim nga 10-100 µl që nënkupton sasinë e solucionit që mund të marrë maja e pipetes e vendosur në këtë mikropipete. Pra sic verifikohet rangun e komandimit të marrjes së solucionit bëhet që nga mikropipeta, që do të thotë nuk ka lidhje me diapazonin që ofrohet nga maja e pipetes që është 5-100 µl.

Vec kësaj theksojmë që: Kompania jone ka ofruar maja pipete me filter të njohura edhe si majat e barrieres së aerosolit, që shërbejnë për qëllimin themelor të mbrojtjes së pipetave nga aerosolet dhe aspirimi i solucionëve të paqendrueshëm ose viskoze, duke shmangur kontaminimin dhe demtimin e mikropipetes. Ky sistem filtrimi i majës së pipetes është me i shtrenjtë, me efektiv dhe me cilësori për të arritur rezultate sa më të sakta në procesin e testimit laboratorik. Pra jo vetëm që kemi prezantuar artikullin që AK kërkon, por kemi prezantuar artikull me cilësori që shmang kontaminimin dhe demtimin e mikropipetes [...]

*Persa i perket proves qe eshte bere nga institucioni AK duke qene se nuk kemi qene prezent per ta pare demonstrimin e majes se pipetes do te kerkojme ekspertizen nga eksperte te fushes gjithashtu dhe ne prezencen tone. Qe te verifikohet nese:*

- 1. mikropipeta eshte Ependorf apo ndonje marke tjeter,*
- 2. nese mikropipeta eshte 10-100 µl,*
- 3. nese gjendja e mikropipetes eshte ose jo e rregullt*
- 4. te testoje majen e pipetes (mostren) te dorezuar nga OE Almedical nese qendron apo jo ne mikropipeten Ependorf qe AK ka cilesuar ne DST.*

III.3.1. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar në sistem, shkresa Nr. 1629 Prot., datë 19.06.2024 protokolluar me tonën me Nr.1597/3, datë 19.06.2024, dhe në formë shresore protokolluar me tonën me Nr. 1597/4, datë 20.06.2024 me objekt “*Kthim përgjigje Ankesës së operatorit ekonomik ALMedical SHPK*”, për dijeni KPP-së dhe të gjithë OE të interesuar”.

III.3.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të ofertë sw operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK, ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronike rezulton, se në përmbushje të kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit sipër cituar, operatori ka ngarkuar:

#### **Katalogu ALMedical.pdf (i perkthyer dhe noterizuar)**

III.3.3. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në marrjen e vendimeve mban parasysht, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit*, Komisioni, në jurisprudencën e tij, e ka bërë pjesë të standardeve për një proces të rregullt ligjor edhe respektimin e parimit të kontradiktoritetit. Për sa më sipër, parimi i kontradiktoritetit, i parë në këndvështrimin e barazisë së armëve në procesin administrativ, është një evolucion logjik i të drejtës së palës për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë dhe të barabartë nga një gjyqtar (arbitër) i drejtë dhe i paanshëm, i cili u garanton të dyja palëve të njëjtat mundësi, për të shpalosur provat dhe argumentet e tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në shqyrtimin administrativ, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, dhe për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues dhe ligjor për të garantuar një proces të rregullt ligjor.

Ndaj për këtë qëllim, Komisioni organizoi një seancë dëgjimore mes palëve në lidhje me arsyen e skualifikimit dhe përmbushjen e specifikimeve teknike nga ana e operatorit ekonomik ankimes.

III.3.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale,

kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike dhe kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi.

KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, konkretisht **pikës 2.3. pika b) dhe d)** rezulton, se është kërkuar shprehimisht që:

**b) Për të gjithë artikujt e kërkuar** sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike), **te paraqitet Katalogje, ku te përfshihen specifikimet teknike të hollësishme për artikullin e kërkuar**(pjeset e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (te **markuara sipas artikullit**) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

**d) Për artikujt e shënuar me Asterisko (\*)**, duhet të paraqiten mostra ditën e hapjes së ofertave, me datë 13.05.2024 në orën 10:00. Dorëzimi i kampionëve/ mostrave, të bëhet pranë Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse pranë NJVKSH Tiranë, të mbyllura në një zarf /kufi jo transparente të vulosur....:

Referuar ankesës, Operatori ekonomik ankimues "ALMedical" SHPK i skualifikuar për mospërmbushje të specifikimeve teknike për artikullin **nr. 14 Maja pipete, Maja për mikropipete Ependorf, ose ekuivalent, 10-100 µl**, me arsyen e skualifikimit se:

*"Artikulli me nr 14, maja pipete, Maja për mikropipete Ependorf, ose ekuivalent, 10-100 µl , e operatorit ekonomik Almedical, nuk janë të përshtatshme për mikropipetën (10-100 µl) që procedojmë. Maja nuk qëndron e fiksuar dhe bie, gjë që bën të pamundur procedimin me të. Në katalogun e dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike nga operatorit ekonomik Almedical, Artikulli me nr 14 është markuar për 5-100 µl."*

argumentuar shkurtimisht nga ankimuesi:

*Kerkojme eksperte të fushës për verifikimet e mëposhtme: (Te verifikohet rregullsisht e pipetes dhe modeli i pipetes ku është provuar mostra, Te verifikohet nëse mikropipeta është 10-100µl Te verifikohet nëse maja bie (sipas pretendimit të KVO,*

**Gjatë Seancën dëgjimore** të zhvilluar në mjediset e KPP-së më datë 16.07.2024, lidhur me arsyen e mësipërme të skualifikimit dhe pretendimet e ankimuesit “ALMedical” SHPK, iu dha mundësi palëve të shprehin argumentet e tyre në lidhje me përputhshmërinë e specifikimeve teknike me mostrën objekt skualifikimi lidhur me sa më sipërcituar.

Komisioni pyeti palët në lidhje me kërkesat paraprake dhe u vërejt se nuk kishte kërkesa paraprake, pranuar nga palët në seancën dëgjimore.

**KPP:** *Fillimisht kërkoi që AK të sillte mostrat e ankimuesit ALMedical në seancën dëgjimore mbi përputhshmërinë e mostrës me specifikimet teknike. Pyetje për OE nëse mostra e sjellë në seancë ishte mostra e tij e dorëzuar pranë AK në ditën e hapjes së procedurës?*

*OE verifikoi mostrën dhe pranoi se ajo ishte mostra e tij.*

**KPP:** *Cilin specifikim nuk përmbush mostra e ankimuesit Si ka arritur të evidentojë mospermbushjen e specifikimeve teknike të mostres art. 14. Si jane testuar mostrat, kane qenë OE në dijeni për testimin e tyre dhe a kanë qenë prezent?*

**AK:** *Ne e kemi shprehur edhe ne vlerësimin e tyre si janë testuar. AK ka mbajtur dokumentacionin për dorëzimin dhe procesin e testimin të mostrave për testim nga mjeket specialist. OE nuk kanë qenë prezent kur janë testuar mostrat. Ka raport teknik për dorëzim për testim dhe rezultatet e testimin nga mjekët përkatës që përdorin pipetat.*

**KPP:** *Kërkoi dorëzim të dokumenteve të testimin pranë KPP-së të cilat mund të sillen edhe në një datë tjetër nëse AK nuk i ka.*

**OE:** *AK nuk ka përcaktuar qarte pajisjen që mban majen e pipetës, 10-100 µl Nëse ka kërkuar maja ependorf edhe pajisja duhet të jetë ependorf. Pra pajisja duhet të jetë ependorf.*

**AK:** *Ne spec-tek është Maja pipete, Maja për mikropipete Ependorf ose ekuivalent, 10-100 µl Kemi disa lloj mikropipeta Ependorf ose ekuivalent. Maja juaj nuk është ekuivalente dhe nuk i bën mikropipetës. Ne kemi disa lloj mikropipeta.*

**OE:** *Pajisje është për ependorf ne kemi maja ependorf për disa marka gilson pedin etj*

**AK:** *Maja juaj nuk qëndron në mikropipetë dhe ta provojmë pasi kemi mikropipetat me vete.*

**OE:** *Ne kemi kërkuar ekspert nëse mikropipeta është ajo që është përmendur në specifikime.*

**KPP:** *Pyetje për OE a jeni dakort të testohet Maja e pipetës nga AK në seancë?*

**OE:** *Po të testohet por të bëj kontroll nëse është mostra jonë. (OE verifikoi mostrën e tij)*

**KPP:** *Mqs OE pranon testim të pipetës vijojmë me testim.*

*OE pranon që është mostra e tij dhe verifikon mikropipetën. AK nuk ka dhënë përshkrim për mikropipeta, dhe është në kundërshtim me Ligjin duhej të përshkruhej Ependorf apo edhe Human DE.... që ne të gjenim pipetat e përshatshme.*

**AK:** *Në institucionin tonë kemi disa lloje dhe kemi shënuar ekuivalente. Dhe kemi përdorur ependorf. Për disa vite*

**OE:** *duhet të jepni emrin e pajisjes edhe disa emertime mikropipeta dhe AK të jepni emrin e pajisjes që ne të gjenim të përshatshmen për ju AK duhet të jepni emrin e pajisjes.*

**AK:** *OE e tjerë i kanë paraqitur maja pipetat që i kanë bërë pajisjeve tona dhe nuk kanë pasur probleme*

**KPP:** *Sa modele keni ju dhe pse keni përdorur si orientim markën ependorf?*

**AK:** *Ependorf është emer marke dhe kemi shume vite që i përdorim dhe maja e pipetës së OE nuk qëndron e fiksuar*

*OE: AK nuk ka dhene marken e pipetës dhe ne te gjenim te duhurën. Specifikimet teknike nuk mund te jene ekuivalente me pajisjen dhe orientimi që AK ka dhene me marken nuk ka qene i qarte për OE duke paraqitur marken e pershtatshme....*

*KPP: Pse AK ka dhene nje marke endorff dhe nuk e ka lënë të hapur*

*AK: Me endorff janë të njohur mjekët dhe ka qenë te suksesshme. OE e tjrerë i kanë paraqitur majat e pipetës të cilat kanë qëndruar në mikropipetën.*

*KPP: Të vijojmë përse kohë palët kërkojnë testimin të vijojmë me testimin.*

Operatori ekonomik ankimues “ALMedical” SHPK, gjatë seancës dëgjimore, iu dha mundësia të evidentonte përmbushjen specifikimeve teknike, nëpërmjet shfaqjes së dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (katalogët) nga ankimuesi, nëpërmjet shfaqjes së këtij dokumentacioni në një ekran LED.

Në seancë u testua mostra e ankimuesit nga përfaqësueset e AK-së.

Përfundimisht në seancë OE pretendon se Specifikimet teknike kanë orientuar gabim OE.

III.3.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specififikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specififikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon se, parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë.

Autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specififikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit.

Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë.

Gjithashtu referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”.

Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “*Specifikime teknike*” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për praninë të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira;

b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: “specifikim teknik” nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Çëshjta C-368/10 “Komisioni European vs. Mberëtëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve



teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”

III.3.6. Në këtë kuptim KPP gjykon referuar dokumentacionit të dosjes administrative si edhe seancës dëgjimore të datë 16.07.2024, ku palët argumentuan qëndrimet e tyre në lidhje me specifikimet teknike dhe vlerësimin e mostrave.

Komisioni përsa referuar më sipër konstaton se autoriteti kontraktor me specifikimet teknike objekt-ankimi, ka vështirësuar operatorët ekonomikë pjesëmarrësve, duke ulur konkurrencën dhe duke sjellë vështirësi tek ofertuesit të interesuar për këtë procedurë prokurimi. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor gjatë hartimit të specifikimeve teknike të dokumenteve të prokurimit objekt-ankimi, duhet të kishte pasur parasysh parashikimet ligjore e konkretisht, neneve 2, 3 dhe 36 të ligjit Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar. Në këto kushte, KPP gjykon, se specifikimet teknike sa më sipër hartuar nga autoriteti kontraktor, kanë shkaktuar konfuzion të operatorët ekonomikë si edhe pabarazi në vlerësimin e ofertuesve dhe njëherazi ka vështirësuar punën e KVO-së, duke u bërë shkak për ankesa në vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

Dokumentet e tenderit duhet të jenë të qarta dhe të sakta në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Mospërcaktimi i saktë i specifikimeve teknike shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”i ndryshuar, *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;* nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “*Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj*”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” [...]”, gjykon, se për shkak të konfuzionit të krijuar procedura e prokurimit duhet të anulohet nga autoriteti kontraktor dhe në rishpalljen e saj autoriteti duhet të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi duke saktësuar specifikimet teknike.

Sa më sipër, pretendimet e ankimuesi qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-03081-04-30-2024, me objekt “Blerje Qelqurina”, me fond limit 4,028,936. lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ALMedical” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-03081-04-30-2024, me objekt “Blerje Qelqurina”, me fond limit 4,028,936. lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Tiranë.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor përpara se të rishpallë procedurën, të sjellë pranë KPP-së kopje të DST me modifikime sipas konstatimeve të këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK dhe operatori ekonomik “ALMedical” SHPK
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**